

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“BeautyCure Liudmila A” SHPK

Sot më datë, 28.08.2018 ne shtetasit :

- **Liudmila Siarhei Ahafonava**, e datëlindjes 02.01.1987, e lindur në Bjellorusi , e cila identifikohet me pasaportën bjelloruse nr KH2043418 me banim në Rruga “Bedri Karapici” nr.3 , banesë private, Tiranë, me cilesinë e ortakes ;
- **Ajvol Ajet Kadiu** , i datëlindjes 07.03.1984, i lindur në Corovodë, Skrapar, Shqipëri, i cili identifikohet me pasaportën shqiptare nr BF8535261 dhe nr. personal I40307002D, me banim në Rruga “Bedri Karapici” nr.3 , banesë private, Tiranë, me cilesinë e ortakut ,

kemi redaktuar këtë akt themelimi, nëpërmjet të cilit deklarojmë se me vullnet të lire të plotë dhe inisiativen e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “ Për shoqëritë tregtare ” në ligjin “ Për Qendrën Kombëtare të Biznesit ”, në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, vendosëm të krijojmë shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, “ **BeautyCure Liudmila A**”

Neni 1

Krijimi

Shoqëria “ **BeautyCure Liudmila A**” , është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (këtu e më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.



Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria “ **BeautyCure Liudmila A**” , është një e tillë, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakët që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë në Adresën:



Rruga " Mikel Maruli", Pallati " ORMARS 2000" , Shkalla nr. 5/1 , Apartamenti nr.2, Tiranë.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit të biznesit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 5
Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm :

Objekti i veprimtarisë është importi i produkteve të ndryshme kozmetike. Shpërndarja e tyre, shitje me shumicë dhe pakicë e produkteve kozmetike, aparateve të përdorura në kozmetikën estetike. Import, përfaqësim dhe shitje me shumicë dhe pakicë e produkteve të markës Neonail professional.

Hapje e një qendre estetike si dhe shërbimeve të ndryshme në fushën e parukerisë dhe estetikës.

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë dhe është i ndarë në 2 kuota ,

vlera nominale e të cilës është:

- Liudmila Ahafonava , 1 kuotë me vlerë nominale 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë; të zotëruara nga ortaku, të cilat përbëjnë 60% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

- Ajvol Kadiu 1 kuotë me vlerë nominale 40.000 (dyzetë mijë) lekë; të zotëruara nga ortaku, të cilat përbëjnë 40% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregëtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7
Organi Vendimmarrës

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo



ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e ortakëve brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratorët, të cilët mund të përfaqësohen edhe nga një tjetër person, nëpërmjet prokurës.

Administratorët – Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Neni 8

Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga Asambleja e ortakëve.

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB –së për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 9

Administrimi

Administratorët emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së ortakëve të shoqërisë. Asambleja e ortakëve vendos për sistemin e administrimit, dhe në rastin e një organi administrativ me shumë administratorë, përcakton numrin e tyre dhe kompetencat.

Administratori/rët, mund të jenë ose jo ortakë.

Administratori mund të shkarkohet në çdo kohë.

Administratoree shoqërisë është Liudmila Siarhei Ahafonava për një periudhë 5 vjeçare sipas ligjit.

Neni 10

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për shoqëritë tregtare".

Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë që ka lidhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 11

Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi pasi u redaktua dhe lexua nga ortakët themelues, miratohet në parim dhe nen për nen nga ortakët themelues të shoqërisë tregtare dhe nënshkruhet prej tyre

ORTAKËT THEMELUES

LIUDMILA AHAFONAVA

Liudmila Ahafonava
Auf

AJVOL KADIU

AJVOL KADIU
AJVOL